



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI**

Nr. 1224/10 Prot.

Tiranë, më 19.12.2018

V E N D I M

Nr. 216, Datë 19.12.2018

**PËR
MBI EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR
NJËSITË E ZBATIMIT TË PROJEKTEVE ME FINANCIME TË HUAJA
“PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E
MËPARSHME TË EVADUARA NË PERIU DHËN TETOR 2017- PRILL
2018”**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Shoqërive Publike dhe Departamentit të Auditimit të IT dhe Projekteve me Financime të Huaja, shpjegimet e dhëna nga subjektet e audituara, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm dhe mendimin e Drejtorit të Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 15, 25, 26 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Kryetarit nr. 1, datë 04.11.2016, “*Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me ndjekjen e zbatimit të masave të rekomanduara dhe dokumentacion që hartohet në auditimin e verifikimit të zbatimit rekomandimeve të KLSH*”, nga ku rezultoi se:

Në **3** subjekte të audituara, janë rekomanduar nga KLSH gjithsej **44** masa, nga të cilat janë pranuar **43.5** masa ose **98.9** %, janë zbatuar plotësisht **27** prej tyre, ose **61.4** %, janë në proces zbatimi **5.5** masa, ose **12.5** % dhe nuk janë zbatuar **11** masa ose **25** %.

Të analizuara sipas llojit të masave të rekomanduara, zbatimi i tyre rezulton:

a-Masa organizative, janë rekomanduar nga KLSH gjithsej **28** masa, nga të cilat janë pranuar **28** masa ose **100%**, janë zbatuar plotësisht **25** prej tyre, ose **89.3** %, janë në proces zbatimi **3** masa ose **10.7%**.

b-Masa për shpërblim dëmi, janë rekomanduar nga KLSH gjithsej **2** masa, për vlerën **9,235** mijë lekë, nga të cilat janë pranuar **1.5** masa në vlerë **7,468** mijë lekë ose **80.9%**, dhe pa pranuar **0.5** masë në vlerën **1,767 mijë lekë** ose **19.1 %**. Nga masat e pranuar janë në proces **1.5** masa në vlerën **7,468 mijë lekë**.

c-Masa për shpenzime/të ardhura jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit, janë rekomanduar nga KLSH gjithsej **4** masa, në vlerën **46,799** mijë lekë, të cilat janë pranuar plotësisht ose **100%**. Nga këto masa janë zbatuar plotësisht **2** prej tyre në vlerë **12,175** mijë lekë ose në masën **26 %**, është në proces zbatimi **1** masa në vlerën **21,688 mijë lekë** ose **46.3 %**, dhe nuk është zbatuar **1** masa në vlerën **12,936 lekë** ose në masën **27.7 %**.

d-Masa administrative. Në këto tre subjekte nuk janë rekomanduar masa administrative.

e-Masa disiplinore, janë rekomanduar nga KLSH gjithsej **10** masa, nga të cilat janë pranuar **10** masa ose **100%**, dhe nuk janë zbatuar **10** masa ose **100 %**.

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduar në periudhën Tetor 2017 - Prill 2018”.

II. Të rikërkoj marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve si më poshtë:

1- NË FONDIN SHOIPTAR TË ZHVILLIMIT PËR PROJEKTIN “GJELBËRIMI I SHËTITORES SË VIJËS BREGDETARE TË VLORËS DHE “ MBUSHJA ME RËRË E PLAZHIT VLORË”

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve në zbatim të programit 1224, datë 31.10.2018 ,dërguar në FSHZH me shkresën nr. 1224/5, datë 21.11.2018 “Dërgim Projekt Raporti”, rezultoi se FSHZH, nuk ka zbatuar afatin 6 mujor të kthimit të përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve në kundërshtim me nenin 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Niveli i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH paraqitet si më poshtë vijon:

-Janë rekomanduar 9 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 8 masa, është në proces zbatimi 1 masë organizative.

-Janë rekomanduar 2 masa për shpërblim dëmi në vlerën 9235 mijë lekë, nga të cilat janë pranuar 1.5 masa në vlerën 7,468 mijë lekë dhe 0.5 masë e pa pranuar në vlerën 1,767 mijë lekë. 1.5 masat e rekomanduar në vlerën 7,468 mijë lekë janë në proces (shumë e pa arkëtuar).

-Janë rekomanduar 3 masa për shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit, të cilat janë pranuar plotësisht dhe ku 2 masa janë realizuar plotësisht dhe 1 masë rezulton e pa zbatuar.

-Janë rekomanduar 10 masa disiplinore, të cilat janë pranuar dhe rezultojnë të pa zbatuara

Për sa më sipër rekomandojmë si më poshtë vijon:

A. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Gjetje nga auditimi 1: Nga auditimi i dosjes teknike të objektit “Mbushja detare e projektit të mbushjes me rërë e plazhit të Vlorës”, u konstatua se operatori ekonomik “K..” ka përfituar më tepër vlerën **6,924,043 lekë me tvsh**, për punime të pakryera, në kundërshtim me Ligjin 8402

datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinën e punimeve të ndërtimit”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4/1, faqet 5-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe i korrespondon rekomandimit 1).

Rekomandim 1:

Fondit Shqiptar i Zhvillimit të ndjekë të gjithë procedurat administrative dhe ligjore për kthimin në Buxhetin e Shtetit të vlerës prej **6,924,043 lekë me tvsh** nga operatori ekonomik “K..” .

B. SHPENZIME JO NË PËRPUTHJE ME PARIMET E EKONOMICITETIT, EFIÇENCËS DHE EFEKTIVITETIT

Gjetje nga auditimi 1: Me Urdhrin e prokurimit nr. 4/1, datë 11.01.2015, për objektin “Shërbimi i supervizimit për mbushjen me rërë të plazhit të Vlorës”, është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor procedura e prokurimit “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, me arsyen e përdorimit “Ligji nr. 9643, datë 20.10.2006, neni 33, pika 5/a”.

Zbatimi i nenit 33, pika 5/a të Ligjit nr. 9643, datë 20.10.2006, shtesa e kontratës nëpërmjet procedurës “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, mund të bëhet vetëm kur kontratës fillestare i ndryshojnë faktorët “kohë” / “vlerë” dhe i mbeten të pandryshuar faktorët “objekt” dhe “Palë”. Në rastin në fjalë, kontrata e quajtur “fillestare” nga ana e AK, ka objekt “Projektimi i vijës bregdetare të Vlorës, Lungomare”, ndërsa kontrata që po shqyrtojmë ka objekt “Shërbimi i supervizimit të mbushjes me rërë të Plazhit të Vlorës”, pra janë dy objekte prokurimi të ndryshme. Në këto rrethana, vlera prej 92,400 Euro (rreth 12,936,000 lekë) pa tvsh është shpenzim joefektiv. (Më hollësisht trajtuar në faqet 5-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe i korrespondon rekomandimit 3).

Rekomandim 1

FSHZH të analizojë, nëpërmjet strukturës së Auditit të Brendshëm, përgjegjësitë për përzgjedhjen e kësaj procedure dhe të marrë masa që në të ardhmen zgjedhja e procedurës së prokurimit në objektet që realizohen me fondet e Buxhetit të Shtetit të bëhet sipas përcaktimeve të legjislacionit shqiptar të prokurimeve.

C.MASA DISIPLINORE

C.1. Mbështetur në nenin 37 të “Kodit të Punës” si dhe pikës 377, germa a, b, c dhe d, të Manualit të Procedurave të FSHZH-së, i rekomandoj Drejtorit Ekzekutiv të FSHZH-së, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim” deri në “Kalim në detyrë apo nivel page më të ulët nga 30 ditë deri në 1 vit”, në zbatim të nenit 12 të Kontratës individuale të punës, për personat si më poshtë:

Rekomandim i lënë:

1. T. B me detyrë Drejtor i Infrastrukturës, pasi:

- në cilësinë e Kryetarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “Mbushja me rërë e Plazhit të Vlorës”, ka kualifikuar BOE “C” & “R” shpk me mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;
- në cilësinë e Drejtorit të Infrastrukturës, ka propozuar procedurën e prokurimit “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, për objektin “Shërbimi i supervizimit të mbushjes me rërë të Plazhit të Vlorës”, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.10.2006, neni 33, pika 5/a dhe për pasojë është kryer shpenzim joefektiv me vlerë 92,400 Euro pa tvsh.
- në cilësinë e Kryetarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “Gjelbërimi i shëtitores së vijës bregdetare Vlorë”, ka kualifikuar OE “G.” shpk me mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

2. E. O me detyrë Koordinator i KFW, pasi:

- në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “Mbushja me rërë e Plazhit të Vlorës”, ka kualifikuar BOE “C” & “R” shpk me mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

- në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “*Shërbimi i supervizimit të mbushjes me rërë të Plazhit të Vlorës*”, është pranuar si fitues operatori Ekonomik “X..”, i cili nuk plotëson kërkesat e kërkuara në Dokumentet e Tenderit, në kundërshtim me nenin 46 të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

- në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “Gjelbërimi i shëtitorës së vijës bregdetare Vlorë”, ka kualifikuar OE “G..” shpk me mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

3. E. Q, me detyrë përgjegjës i Njësisë së Projekteve të Infrastrukturës Rrugore, pasi:

- në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “Mbushja me rërë e Plazhit të Vlorës”, ka kualifikuar BOE “C” & “R..” shpk me mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

- në cilësinë e Përgjegjësit të Njësisë së Projekteve të Infrastrukturës Rrugore, ka propozuar procedurën e prokurimit “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, për objektin “*Shërbimi i supervizimit të mbushjes me rërë të Plazhit të Vlorës*”, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.10.2006, neni 33, pika 5/a dhe për pasojë është kryer shpenzim joefektiv me vlerë 92,400 Euro pa tvsh.

- në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “Gjelbërimi i shëtitorës së vijës bregdetare Vlorë”, ka kualifikuar OE “G..” shpk me mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

4. D. M, me detyrë specialist i Njësisë së Projekteve të Infrastrukturës Rrugore, pasi:

- në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “Mbushja me rërë e Plazhit të Vlorës”, ka kualifikuar BOE “C..” & “R..” shpk me mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

- në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “*Mbrojtja detare e projektit të mbushjes me rërë të Plazhit të Vlorës*”, ka kualifikuar OE “K..” me mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

- në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “*Shërbimi i supervizimit të mbushjes me rërë të Plazhit të Vlorës*”, ka pranuar si fitues operatori Ekonomik “X”, i cili nuk plotëson kërkesat e kërkuara në Dokumentet e Tenderit, në kundërshtim me nenin 46 të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

- në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “Gjelbërimi i shëtitorës së vijës bregdetare Vlorë”, ka kualifikuar OE “G..” shpk me mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

5. L. M, me detyrë përgjegjës i Njësisë së Projekteve Hidroteknike, pasi:

- në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “Mbushja me rërë e Plazhit të Vlorës”, ka kualifikuar BOE “C..” & “R” shpk me mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

- në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “*Mbrojtja detare e projektit të mbushjes me rërë të Plazhit të Vlorës*”, ka kualifikuar OE “K..” me mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

- në cilësinë e kryetarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “*Shërbimi i supervizimit të mbushjes me rërë të Plazhit të Vlorës*”, ka pranuar si fitues operatori Ekonomik

“X.”, i cili nuk plotëson kërkesat e kërkuara në Dokumentet e Tenderit, në kundërshtim me nenin 46 të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

- në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “Gjelbërimi i shëtitores së vijës bregdetare Vlorë”, ka kualifikuar OE “G...” shpk me mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

6. A. P, me detyrë specialist i Njësisë së Prokurimeve, pasi:

- në cilësinë e anëtarit të KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “*Mbrojtja detare e projektit të mbushjes me rërë të Plazhit të Vlorës*”, ka kualifikuar OE “K..” me mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

7. V. K, me detyrë përgjegjës i Njësisë së Prokurimeve, pasi:

- në cilësinë e anëtarit të Nj.P. në procedurën e prokurimit me objekt “Mbushja me rërë e Plazhit të Vlorës”, nuk ka analizuar përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, koston e punëve të këtij objekti;

- në cilësinë e anëtarit të Nj.P. në procedurën e prokurimit me objekt “*Mbrojtja detare e projektit të mbushjes me rërë të Plazhit të Vlorës*”, nuk ka bërë dokumentimin e përlogaritjes së fondit limit përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit dhe ka bërë shtyrjen e afatit të dorëzimit të ofertave me 10 ditë, në kundërshtim me pikat 1 dhe 2/1, të nenit 42 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”;

- në cilësinë e anëtarit të Nj.P. në procedurën e prokurimit me objekt “Gjelbërimi i shëtitores së vijës bregdetare Vlorë”, nuk ka analizuar përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, koston e punëve të këtij objekti dhe për pasojë në këtë objekt, me te njëjtën vlerë të preventivuar nga projektuesi, janë prokuruar 8,166,080 lekë volume punimesh më pak se projekti.

8. A. Z, me detyrë specialist i Njësisë së Prokurimeve, pasi:

- në cilësinë e anëtarit të Nj.P. në procedurën e prokurimit me objekt “Mbushja me rërë e Plazhit të Vlorës”, nuk ka analizuar përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, koston e punëve të këtij objekti;

- në cilësinë e anëtarit të Nj.P. në procedurën e prokurimit me objekt “*Mbrojtja detare e projektit të mbushjes me rërë të Plazhit të Vlorës*”, nuk ka bërë dokumentimin e përlogaritjes së fondit limit përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit dhe ka bërë shtyrjen e afatit të dorëzimit të ofertave me 10 ditë, në kundërshtim me pikat 1 dhe 2/1, të nenit 42 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”;

- në cilësinë e anëtarit të Nj.P. në procedurën e prokurimit me objekt “Gjelbërimi i shëtitores së vijës bregdetare Vlorë”, nuk ka analizuar përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, koston e punëve të këtij objekti dhe për pasojë në këtë objekt, me te njëjtën vlerë të preventivuar nga projektuesi, janë prokuruar 8,166,080 lekë volume punimesh më pak se projekti.

9. M. M, me detyrë specialist i Njësisë së Prokurimeve, pasi:

- në cilësinë e anëtarit të Nj.P. në procedurën e prokurimit me objekt “Mbushja me rërë e Plazhit të Vlorës”, nuk ka analizuar përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, koston e punëve të këtij objekti;

- në cilësinë e anëtarit të Nj.P. në procedurën e prokurimit me objekt “Gjelbërimi i shëtitores së vijës bregdetare Vlorë”, nuk ka analizuar përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, koston e punëve të këtij objekti dhe për pasojë në këtë objekt, me te njëjtën vlerë të preventivuar nga projektuesi, janë prokuruar 8,166,080 lekë volume punimesh më pak se projekti.

10. M. J, me detyrë specialist i Njësisë së Prokurimeve, pasi:

- në cilësinë e anëtarit të Nj.P. në procedurën e prokurimit me objekt “*Mbrojtja detare e projektit të mbushjes me rërë të Plazhit të Vlorës*”, nuk ka bërë dokumentimin e përlogaritjes së fondit

limit përpara nxjerrjes së urdhrimit të prokurimit dhe ka bërë shtyrjen e afatit të dorëzimit të ofertave me 10 ditë, në kundërshtim me pikat 1 dhe 2/1, të nenit 42 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”.

D. TË TJERA

Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces të inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre brenda 3-mujorit të parë të vitit 2019. Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve do të kryhet në auditimin e radhës që KLSH do kryejë në këtë Institucion.

2. NË BASHKINË TIRANË PËR PROJEKTIN “E BULEVARDIT VERIOR TË TIRANËS DHE REHABILITIMI I LUMIT TË TIRANËS”

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve në zbatim të programit 1224, datë 31.10.2018 ,dërguar në Bashkinë Tiranë me shkresën nr. 1224/4, datë 21.11.2018 “Dërgim Projekt Raporti”, rezultoi se Bashkia Tiranë, nuk ka zbatuar afatin 6 mujor të kthimit të përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, në kundërshtim me nenin 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Niveli i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH paraqitet si më poshtë vijon:

-Janë rekomanduar 11 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 8 masë, është në proces zbatimi i 2 masave organizative.

-Është rekomanduar 1 masa për shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficientës dhe efektivitetit, e cila është pranuar plotësisht. Kjo masë është në proces zbatimi.

-Për sa mësipër për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces të inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre brenda 3-mujorit të parë të vitit 2019. Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve do të kryhet në auditimin e radhës që KLSH do kryejë në këtë Institucion.

3. NË MINISTRINË E BUJOËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL PËR PROJEKTIN “E BURIMEVE UJORE DHE UJITJES”

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve në zbatim të programit 1224, datë 31.10.2018 ,dërguar në MBZHR me shkresën nr. 1224/6, datë 21.11.2018 “Dërgim Projekt Raporti”, rezultoi se kjo ministri, nuk ka zbatuar afatin 6 mujor të kthimit të përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, në kundërshtim me nenin 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Niveli i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH paraqitet si më poshtë vijon:

-Janë rekomanduar 9 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht dhe janë zbatuar plotësisht.

Rekomandimet për zbatimin e rekomandimeve të rezultuara të pazbatuara nga auditimi i ushtruar “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduar në periudhën Tetor 2017 – Prill 2018, për çdo subjekt, do të përcillet pjesa e secilit subjekt nga Vendimi i Kryetarit dhe Raporti Përfundimtar i Auditimit.

Me ndjekjen dhe zbatimin e detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Departamenti i Auditimit të IT dhe Investimeve të Huaja.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R